

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	00 Nr.Br.100/2023	Data: Datum: 27.06.2023	

Kuvendi i Komunës së Istogut në bazë të nenit 40.2 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008) si dhe nenin 16 paragrafi 8 pika 8.1 dhe 8.2 i Ligjit Nr. 08/L-066 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, dhe nenit 33.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01Nr.62/10, në mbledhjen e mbajtur më: 27.06.2023, shqyrtoi dhe miratoi propozimin e Kryetarit të Komunës për listën e projekte të reja kapitale në bashkëfinancim me komunitetin për vitin fiskal 2023, dhe merre këtë:

V E N D I M PËR PROJEKTET E REJA E KAPITALE NË BASHKËFINANCIM ME KOMUNITETIN :

1. Projekti "Ndërtimi i rrugëve në fshatrat Orroberdë, Dobrushë, Saradran dhe Dubravë", Ndërtimi i rrugës në Orroberdë lagja "Hakaj", Ndërtimi i rrugës në lagjen "Tuzi" në Dobrushë, Ndërtimi i rrugës në lagjen "Mavraj" në Saradran, Ndërtimi i rrugës në lagjen "Bekaj" në Dubravë.
2. Projekti "Ndërtimi i rrugëve në fshatrat Dragolevc, Istog, Istog i Poshtëm dhe Dushkajë", Ndërtimi i rrugës dhe kanalit vërshues në Dragolevc lagja "Kajtazaj", Ndërtimi i rrugës në lagjen e re, te rruga "Bekim Fehmiu" në Istog, Ndërtimi i rrugës në lagjen "Behlulaj" në Dragolevc, Ndërtimi i rrugës në lagjen "Veselaj" në Istog të Poshtëm, Ndërtimi i trotuarit në rrugën "Spanja" në Dushkajë.
3. Projekti "Ndërtimi i rrethojave në varrezat e fshatrave Zhakovë, Tomoc dhe Kovragë" Ndërtimi i rrethojës së varrezave në lagjen "Idrizaj" në Zhakovë, Ndërtimi i rrethojës së varrezave në Tomoc, Ndërtimi i rrethojës së varrezave në Kovragë, Ndërtimi i murit rrethues së varrezave në fshatin Tomoc të lagjes "Shatri".
4. Projekti "Ndërtimi dhe Renovimi i shtëpive të Kulturës në Fshatrat Dubovë e Vogël dhe Lubovë", Ndërtimi i shtëpisë së Kulturës në fshatin "Dubovë e Vogël", Renovimi i shtëpisë së kulturës së "Lubovë" lagja Kajtazaj dhe Haxhijaj.

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për projektet e reja kapitale në bashkëfinancim me komunitetin për vitin fiskal 2023.
2. Duke u bazuar në ligjin mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, projektet të cila komuna i ka me bashkëfinancim, me rastin e participimit të komitetit ose donatorëve tjerë në nivelin lokal me qeraste krijohet kod i ri të projekteve kapitale në kuadër të nën

programi Buxhetimi 17517 nga "Projekti me participim te Komunitetetit ,ministrive te linjës,Donatoret e jashtëm " me kod 50240.

- 2.1. Në projektin e ri **"Ndërtimi i rrugëve në fshatrat Orroberdë, Dobrushë, Saradran dhe Dubravë"**, në vlerë prej : **49,367.40 euro**, nga të cilat komuna e Istogut bashkë-financon shumën prej: 41,867.40 euro, ndërsa komuniteti participon në shumën prej : 7,500.00 euro.
- 2.2. Në projektin e ri **"Ndërtimi i rrugëve në fshatrat Dragolevc, Istog, Istog i Poshtëm dhe Dushkajë"**, në vlerë prej : **88,872.00 euro**, nga të cilat komuna e Istogut bashkë-financon shumën prej: 77,072.00 euro, ndërsa komuniteti participon në shumën prej : 11,800.00 euro.
- 2.3. Në projektin e ri **"Ndërtimi i rrethojave në varrezat e fshatrave Zhakovë, Tomoc dhe Kovragë"**, në vlerë prej : **39,216.20 euro**, nga të cilat komuna e Istogut bashkë-financon shumën prej: 28,416.20 euro, ndërsa komuniteti participon në shumën prej : 10,800.00 euro.
- 2.4. Në projektin e ri **"Ndërtimi dhe Renovimi i shtëpive të Kulturës në Fshatrat Dubovë e Vogël dhe Lubovë"**, në vlerë prej : **45,600.00 euro**, nga të cilat komuna e Istogut bashkë-financon shumën prej: 39,600.00 euro, ndërsa komuniteti participon në shumën prej : 6,000.00 euro.
3. Autorizohet Drejtori për Buxhet dhe Financa dhe Zyrtari Kryesor Financiar që më planin e Rishikimit të buxhetit komunal të njoftojë Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave për procedim të mëtejshëm në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi.
4. Ky Vendim hynë në fuqi 15 (pesëmbëdhjete) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit të tij në faqen zyrtare të Komunës. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesën: Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.
5. Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Departamenti i Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, Departamenti i Përgjithshëm i Thesarit në Prishtinë, Kryetari i Komunës, Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF) dhe një kopje në arkivin e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit,
z. Enver Rugova

